



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M


Nr.12, datë 09.11.2022

PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË TË SIPËRFAQES SË NDËRTUAR NË
TEJKALIM TË LEJES SË NDËRTIMIT, PËR QËLLIM FITIMI, NË OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 6 KAT”,
ME VENDNDODHJE NË QERRET, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të sipërfaqes prej 178.6 m², të ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit, për qëllim fitimi, në objektin e miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.39, datë 28.12.2020 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë banimi dhe shërbimesh 6 kat”, me vendndodhje në Qerret, Bashkia Kavajë, me zhvillues shoqërinë “Vezi Group” sh.p.k.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkalim të lejes së ndërtimit.
5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.



6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Kavajë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I BRENDSHËM

BLEDAR ÇUÇI



ANËTAR

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

